



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 748/6 Prot

Tiranë, më 01/10/2013

REKOMANDIM

Nr. 25 datë 01/10/2013

Mbështetur në ligj nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organizative dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetimit Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit *Klinika "Ama Vita", Berat*.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 130 datë 03.07.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit *Klinika "Ama Vita"* me adresë, *Rr. Rilindja, pranë Spitalit Rajonal, Berat*. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Ploësimi i detyrimit për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).
- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi *Klinika "Ama Vita", Berat*, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Pacient".
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale të pacientëve (neni 27).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi *Klinika "Ama Vita"* kryen aktivitetin e tij privat në fushën e kujdesit shëndetësor dhe gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale/sensitive për kategorinë pacientë.

Për kategorinë “pacient” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi përpunon të dhëna të tilla si analiza gaku dhe eko. Kontrolluesi nuk mban kartela pacientësh, gjithashtu rezultatet e analizave i jepen pacientit drejtpërdrejt dhe nuk mbahen evidenca.

Nga inspektimi i kryer në terren dhe në kompjuterin e klinikës konstatohet se kontrolluesi nuk mban të dhëna personale/sensitive të pacientëve në formë shkrimesore apo elektronike.

Të dhënat personale të pacientëve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mbledhen dhe përpunohen. Qëllim: i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për pacientët është vetëm ofrimi i shërbimeve në fushën e kujdesit shëndetësor.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të pacientëve (neni 27 i ligjit), kontrolluesi *Klinika “Ama Vita”* duhet të hartojë një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale në të cilën të parashikohen masa konkrete për përpunimin, sigurinë, detyrimet e tij dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Bazuar në rregulloren të publikuar në faqen zyrtare www.kmdp.al).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, në kuadër të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, personat që kanë akses në analizat e pacientëve, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale (në zbatimin e nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. P. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të pacientëve. (Rregulloren tip mund ta gjëni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, personat që kanë akses në analizat e pacientëve, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale;
3. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit:

“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në K.u.vend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

